



DREJTORIA E ARSIMIT
DIREKCIJA OBRAZOVANJE
DIREKTORATE OF EDUCATION

tel / Fax: 0290/320-149
e-mail: dreadars@gmail.com
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

DATA/DATUM/DATE	25.01.2021
NR/BR.	794
PËR/ZA/TO	TABELËN E SHPALLJEVE
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Llabjani
NGA/OD/FROM	Sektorit të administratës së Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Vendim për pranim në punë

Mbështetur në nenin 12, të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për Rregullimin Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Komisioni i përzgjedhës më datën 25.01.2021 nxjerr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E REZULTATEVE TË PRANIMIT SIPAS KONKURSIT

Komisioni përzgjedhës shpall rezultatet e pranimit të kandidatëve për mësimdhënës sipas konkursit nr.771 të datës 31.12.2020, të publikuar nga Drejtoria e Arsimit për vendin e punës: **Dy mësimdhënës për lëndën Piano (zëvendësim) në SHML e Muzikës “Çesk Zadeja”, Ferizaj**, pranohen këto kandidatë: Manjola Xhigoli që fitoi 84.3 % dhe Edona Ismajli që fitoi 83 % të pikëve të fituara. Në vendin e punës: **Mësues klase në SHFMU „Ahmet Hoxha” Ferizaj**, pranohet kandidatja Fatime Shumolli, që fitoi 85.5 % të pikëve të fituara, si dhe për vendin e punës: **Mësues klase, në SHFMU „Besim Rexhepi” në fshatin Komogllavë**, pranohet kandidatja Arbenita Sylejmani, e cila fitoi 84.6% të pikëve të fituara.

Kandidatët tjerë kanë fituar më pak pikë.

A r s y e t i m

Në bazë të konkursit nr.771 të datës 31.12.2020 të publikuar nga Drejtoria e Arsimit, për pranimin e kandidatëve, për mësimdhënës, Komisioni përzgjedhës ka zhvilluar procedurat e intervistimit dhe vlerësimit sipas konkursit të lartëcekur.

Gjithashtu pas përfundimit të procedurave të vlerësimit të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për vendin e lart cekur të punës, Komisioni Përzgjedhës ka marr vendim për shpalljen e rezultateve të pranimit të kandidatëve të cilët kanë fituar më së shumti pikë. Nga të dhënat e shënuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Aplikuesi i pakënaqur me vendimin për përzgjedhje mund të ushtroj ankesë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankesa i drejtohet Komisionit të Ankesave për mes Zyrës së Personelit në Komunë.
DA, Ferizaj.